

Përfitimi i kombësisë luksemburjeze nëpërmjet marrjes së shtetësisë

Kushtet që duhen përmbushur

- Të kesh mbushur 18 vjeç në momentin e aplikimit;
- Të kesh qëndruar në mënyrë legale dhe realisht në Luksemburg për 7 vite të njëpasnjëshme.
Vërejtje: Për personat të cilëve në kuadrin e Konventës së Gjenevës u është njohur statusi i refugjatit në Luksemburg, periudha ndërmjet datës së depozitimit të kërkesës së tyre për azil dhe datës së njohjes së statusit të refugjatit nga ministria kompetente merret në konsideratë për llogaritjen e 7 vjetëve. Për ta provuar këtë, është e nevojshme të dorëzohet një certifikatë e lëshuar nga ministria që ka Imigrimin në kompetencat e saj;
- Të kesh kaluar me sukses një provim gojor në gjuhën luksemburjeze (shih më poshtë «Provimi i gjuhës »);
- Të kesh ndjekur 3 seanca udhëzimesh qytetarie. (shih më poshtë « Seanca udhëzimesh qytetarie » ;
- Të përmbushësh kërkesat e të qenit i ndershëm. (shih më poshtë « Kushti i të qenit i ndershëm »).

Përfundim: Veç kushteve të përmendura më sipër, kombësia mund të jepet apo të atribuohet për shërbime të jashtëzakonshme që i janë bërë shtetit.

Provimi i gjuhës

Provimi i gjuhës përfshin të shprehurit dhe të kuptuarit me gojë.

Niveli i provimit të të shprehurit me gojë i përket nivelit A2 të Kuadrin të përgjithshëm evropian që shërben si referencë për gjuhët përse i përket të shprehurit dhe komunikimit gojor. Kandidati duhet të jetë i aftë të prezantohet dhe të falsë me fjalë të thjeshta për familjen e tij, për persona të tjerë, për kushtet e jetesës, për edukimin apo profesionin e tij. Duhet të jetë i aftë të përshkojë e të krahasojë në mënyrë të thjeshtë njerëzit, gjërat, dhe aktivitetet. Provimi përbëhet nga një intervistë me egzaminuesin mbi një temë të dhënë dhe nga një përshkrim imazhi. Zgjat rreth 10 minuta.

Niveli i provimit të të kuptuarit gojor i përket nivelin B1 të Kuadrin të përgjithshëm evropian që shërben si referencë për gjuhët përse i përket të kuptuarit me gojë. Kandidati duhet të kuptojë pikat thelbësore kur përdoret një gjuhë e qartë dhe standarte dhe kur bëhet fjale për tema të njohura. Testi i të kuptuarit me gojë zgjat 25 minuta dhe përbëhet nga tre dëgjime pas të cilave kandidati duhet ti përgjigjet një pyetësi.

Për të kaluar me sukses testin e gjuhës, kandidati duhet fitojë të paktën gjysmën e pikëve në secilën nga dy pjesët (pra >50% në të shprehur dhe >50% në të kuptuar).

Është i përjashtuar nga provimi i gjuhës aplikanti:

- Që është shkolluar të paktën 7 vjet në Luksemburg në kuadrin e arsimit publik luksemburjez ose të arsimit privat që aplikon programet e arsimit publik luksemburjez. Për të provuar këtë duhen dorëzuar certifikata të lëshuara nga organet kompetente të komunave në të cilat aplikanti ka ndjekur arsimin parashkollor apo atë fillor, certifikata të lëshuara nga institucionet shkollore në të cilat ai ka ndjekur arsimin e mesëm ose fotokopje të noterizuara të buletineve shkollore;

- Që zotëron një autorizim qëndrimi në Luksemburg që para 31 dhjetorit të 1984 dhe që ka jetuar në Luksemburg që prej të paktën kësaj date. Për ta provuar këtë duhen dorëzuar çertifikata qëndrimi të lëshuara nga komunat kompetente;

Seanca udhëzimesh qytetarie

Është e nevojshme të ndiqen tre seanca udhëzimesh qytetarie. Seancat organizohen në mbrëmje ose të shtunën në mëngjes dhe janë falas. Sipas nevojave, seancat zhvillohen në luksemburgisht, frëngjisht, gjermanisht, anglisht, ose portugalisht. Në fund të këtyre seancave nuk ka ndonjë testim por të intersuarve u lëshohen çertifikata pjesmarrje.

Dy seanca janë të detyrueshme:

- « Të drejtat themeltare të qytetarëve dhe jeta publike » ;
- « Institucionet shtetërore luksemburgeze »

Seanca e tretë mund të zgjidhet nga një listë me tema të tjera.

Është i përjashtuar nga seancat e udhëzimeve të qytetarisë, aplikanti:

- Që është shkolluar të paktën 7 vjet në Luksemburg në kuadrin e arsimit publik luksemburgez ose të arsimit privat që aplikon programet e arsimit publik luksemburgez. Për të provuar këtë duhen dorëzuar çertifikata të lëshuara nga organet kompetente të komunave në të cilat aplikanti ka ndjekur arsimin parashkollor apo atë fillor, çertifikata të lëshuara nga institucionet shkollore në të cilat ai ka ndjekur arsimin e mesëm ose fotokopje të noterizuara të buletineve shkollore;
- Që zotëron një autorizim qëndrimi në Luksemburg që para 31 dhjetorit të 1984 dhe që ka jetuar në Luksemburg që prej të paktën kësaj date. Për ta provuar këtë duhen dorëzuar çertifikata qëndrimi të lëshuara nga komunat kompetente;

Kushti i të qënit i ndershëm

Marrja e shtetësisë i refuzohet aplikantit:

- Që ka bërë pohime false, ka fshehur fakte të rëndësishme, ose ka vepruar me mashtrim në kuadër të kërkesës për marrje shtetësie;
- Që i është dhënë qoftë në Luksemburg qoftë në një vend tjetër një dënim i rënde ose është dënuar për të paktën me një apo më shumë vite burg për një vepër që përbën shkelje penale në të drejtën luksemburgeze. Shkelja nuk përbën pengesë për marrjen e shtetësisë nëse dënimi është egzekutuar në formë përfundimtare para më shumë se 15 vjetëve para se të depozitohet kërkesa për marrje shtetësie.

Si duhet aplikuar

Një kërkesë me shkrim duhet të depozitohet pranë komunës së banimit. Megjithëse i drejtohet komunës kjo kërkesë duhet të ketë adresën e Ministrisë së Drejtësisë. (shih « Organizmat e kontaktit më poshtë »). Komuna ja kalon kërkesën Ministrisë së Drejtësisë. Formulari i kërkesës është i disponueshëm në Ministrinë e Drejtësisë dhe mund të shkarkohet në adresën e internetit www.mj.public.lu dhe në këtë adresë (www.bienvenue.lu).

Kërkesës duhet ti bashkëngjiten dokumentat e mëposhtme:

- Një certifikatë lindje (si edhe një certifikatë e fëmijëve të aplikantit që s' kane arritur moshën madhore) ;
- Një përshkrim egzak i biografisë: Aplikanti duhet të përdorë modelin përshkrimit biografik në formë pyetësori, që i është vënë në dispozicion nga Ministria e Drejtësisë, i shkarkueshëm në adresën e Internetit www.mj.public.lu dhe në adresën (www.bienvenue.lu) ;
- Çertifikata rezidence që përmbledhin 7 vitet e fundit, të disponueshme pranë komunës së banimit të aplikantit;
- Një kopje e noterizuar e pashaportës
- Një apo disa certifikata penale që përmbledhin 15 vitet e fundit ;
- Një certifikatë që dëshmon marrjen e provimit të gjuhës luksemburgete ;
- Një certifikatë pjesmarrje në seancat e udhëzimeve të qytetarisë.

Dokumentat duhet të jenë të përkthyer në frëngjisht apo gjermanisht nga një përkthyes i betuar. Aplikanti duhet ti bashkëngjisë dosjes së kërkesës dhe dokumentat orgjinale. Në rast pamundësie për të paraqitur dokumentat orgjinale ai mund të paraqesë një kopje të noterizuar të tyre. Dokumentet të cilave mund tu ndryshojë përmbajtja duhet të kenë një datë të afërme. Ministria e Drejtësisë mund të kërkojë dhe dokumenta të tjerë nëse e gjykon të nevojshme. Nga të gjitha dokumentat që i bashkëngjiten kërkesës, certifikatat e gjendjes civile duhet të jenë të pajisura me një pullë prej 4€ dhe dokumentat e tjera me një pullë prej 2 eurosh.

Vendimi - Afati – Apeli

Nëse përmbushen kushtet ligjore dhe nëse dosja përmban si kërkesën për marrje nënshtetësie ashtu edhe të gjitha certifikatat që e vërtetojnë, nëpunësi i gjendjes civile dekreton deklaratën e dhënies së shtetësisë. Ai ja kalon dosjen, direkt dhe pa vonesë, Ministrisë së Drejtësisë që e merr nën shqyrtim. Ministria e Drejtësisë jep një përgjigje pozitive apo negative të kërkesës për marrje nënshtetësie brenda një afati që nuk i tejkalon 8 muajt pas depozitimit.

Nëse aplikanti ndodhet në proces gjyqësor për çështje penale mund të urdhërohet pezullimi i dosjes së kërkesës. Në rast pezullimi afati i 8 muajve nuk është i vlefshëm.

Gjatë shqyrtimit të kërkesës dhe para vendimit të Ministrisë, aplikanti s' mund të largohet nga vendi.

Në rast se kërkesa hidhet poshtë, aplikanti mund ta apelojë pranë gjykatës administrative brenda një afati prej 3 mujash duke filluar nga data e njoftimit të vendimit.

Të ndryshme – Për tu ditur

- Luksemburgu pranon parimin e «kombësisë të dyfishtë » (shih kombësinë e shumëfishtë). Megjithatë ligji luksemburget i vetëm nuk mund tu garantojë përfitimin e kombësisë të dyfishtë personave të cilëve u është akorduar shtetësia sepse duhet ta pranojë edhe vendi i orgjinës. Si rrjedhim, aplikanti duhet të informohet pranë autoriteteve kompetente (ambasada apo konsullata e vendit të orgjinës) nëse ligji i vendit të orgjinës gjithashtu e pranon parimin e nacionalitetit të dyfishtë.
- Mund të rimbursoni shpenzimet e regjistrimit në provimet e gjuhës luksemburgete (75€) si edhe shpenzimet e regjistrimit në kurset e gjuhës luksemburgete të ndjekura në Institutin Kombëtar të

Gjuhëve apo në një organizëm tjetër të autorizuar nga Ministria e Arsimit Kombëtar dhe e Edukimit profesional.

- Kërkesat e depozituara para 1 janarit 2009 i nënshtrohen kushteve të ligjit të mëparshëm.
- Ligji nuk e njeh më formulën e variantit apo të qëndrimit të thjeshtuar për bashkëshortët e martuar me një Luksemburgëz.

Organizma kontakti

Ministère de la Justice (Ministria e Drejtësisë)

Service de l'indigénat

L-2934 Luxembourg

Tél.: +352 247-84547 / 84538

Association de Soutien aux Travailleurs Immigrés (Shoqata për Mbështetjen e Imigrantëve)

10-12, rue August Laval

L-1922 Luxembourg

+352 43 83 33 – 1

partenariat@asti.lu

Institut National des Langues (renseignements et inscription aux cours des langues) Instituti Kombëtar i

Gjuhëve (Informacion dhe regjistrim në kurset e gjuhëve)

21, boulevard de la Foire

L -1528 Luxembourg

Tél.: (+352) 26 44 30 - 1

E-mail : secretariat@insl.lu

Ky tekst është vetëm një përmbledhje e hartuar nga ASTI asbl. Vetëm teksti i ligjit është i vlefshëm.